

RELACION
PËR PROJEKT-VENDIMIN
“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR SHPËRNDARJEN E
KOSTOVE TË LIDHURA ME KOORDINIMIN E PUNIMEVE CIVILE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projekt-vendimi “Për miratimin e rregullave për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile” është propozim i Ministrisë për Infrastrukturën dhe Energjinë, në përputhje me pikën 7, të nenit 15, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”. Ky projekt-vendim përcakton rregullat për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projekt-vendimi ka qenë parashikuar në programin analitik të akteve për vitin 2018 dhe vjen si nevojë e plotësimit të kuadrit nënligjor, në zbatim të ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ligji Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, në nenin 14 dhe 15, të tij ka parashikuar koordinimin e punimeve civile, midis operatorëve të rrjeteve me qëllim zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë.

Në nenin 15 në pikën 1, përcaktohen dhe kushtet kur konsiderohet e arsyeshme një kërkesë për koordinimin e punimeve civile. Në pikën 7, të këtij neni është parashikuar që rregullat për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Qëllimi i koordinimit të punimeve civile është reduktimi i kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë duke pasur

parasysh se ato zënë një përqindje të lartë ne 60-70% të totalit të shpenzimeve për rrjetet fikse broadband.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projekt-vendimi është hartuar në mbështetje të nenin 100 të Kushtetutës, pika 2 dhe të nenin 20, pika 4 e Ligjit Nr. 120/2016 *“Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”*.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projekt-vendimi nuk transponon ndonjë akt të veçantë të acquis të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi synon miratimin e rregullave për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile, ku përcaktohen ndër të tjera:

Parimet e koordinimit të punimeve civile në ndërtimin e rrjeteve të shpejtësisë së lartë të komunikimeve elektronike mbi bazën e transparencës, proporcionalitetit dhe orientimit në kosto.

Gjithashtu në nenin 3 nënvizohen kërkesat ligjore se kur koordinimi i punimeve civile për ndërtimin e rrjeteve të shpejtësisë së lartë të komunikimeve elektronike pranohet, rastet kur ajo është e arsyeshme me plotësim e kushteve:

- a) nuk sjell kosto shtesë apo vonesa për fillimin e punimeve civile dhe nuk rrezikon kryerjen e punimeve, sipas afateve të lejes së ndërtimit;
- b) nuk pengon mbikëqyrjen e punimeve civile të koordinuara;
- c) kërkesa për koordinim bëhet sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se një muaj nga paraqitja e projektit final pranë autoritetit planifikues për dhënien e lejes së ndërtimit;
- ç) nuk cenon objektivat dhe funksionalitetin e investimit të operatorit të rrjetit;

d) është në përputhje me parashikimet e legjislacionit që rregullon fushën e veprimtarisë së operatorit të rrjetit.

Në nenin 4, përcaktohet dhe mënyra e shpërndarjes së kostove për punimet civile në rastin e pjesëmarrjes së më shumë se një operatori rrjeti në punimet civile për ndërtimin e rrjetit/eve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë, kostot për punimet civile ndahen në mënyrë përpjestimore midis pjesëmarrësve si dhe jepet formula ku parashikohet përfshirja e gjithë elementeve të kostove të punimeve civile si gërmime dheu, zhvendosje të dheut, kthim në gjendjen e mëparshme si dhe kostot për elementët e mirëmbajtjes së rrjetit (pusetat) që mund të jenë të ndryshme sipas natyrës së rrjetit.

Për efekt të përpjestimit të kostove është përdorur në fomrule dhe Pesha specifike që do përcaktohet mbi bazën e përqindjes në volum të punimeve të secilit operator sipas natyrës, llojit dhe sasisë së elementeve që kërkon ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjetit përkatës të infrastrukturës.

Në nenin 5, përcaktohet se ku do drejtohen palët e interesuara në rast të mosmarrëveshjeve për koordinimin e punimeve civile. Ky përcaktim është në përputhje me parashikimet e nenit 15, të ligjit Nr. 120/2016 “*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit*”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Institucionet që ngarkohet për zbatimin e këtij projekt-vendimi janë autoritetet pergjegjese të parashikuara në nenin 7 të ligjit Nr. 120/2016 “*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit*”.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projekt-vendimi është hartuar nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe mbi bazën e praktikave të Bashkimit Europian për zbatimin e direktivës 2014/61/EU për koordinimin e punimeve civile për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë.

Relacion shpjegues për Projekt-vendimin “Për miratimin e rregullave për shpërndarjen e kostove të lidhura me koordinimin e punimeve civile”.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekt-vendimi nuk ka ndikim në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit.

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

DRAFT